

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Maj 2025

Tiranë, më 24 Qershor 2025: Gjatë muajit Maj 2025, rezultojnë të kenë hyrë, në territorin e Republikës së Shqipërisë, 1.676.222 shtetas shqiptarë dhe të huaj. Ky tregues ka pësuar një rritje me 4,3 %, krahasuar me Maj 2024.


1.655.100 shtetas shqiptarë dhe të huaj rezultojnë të kenë dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë, duke shënuar një rritje me 2,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Hyrjet e shtetasve

Në Maj 2025, numri i shtetasve shqiptarë që kanë hyrë në territorin shqiptar është 689.145, duke pësuar një rritje me 8,9 %, krahasuar me Maj 2024.

Numri i shtetasve të huaj që kanë hyrë në territorin shqiptar është 987.077. Ky numër është rritur me 1,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2024 (fig.1).

Fig.1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri, Maj 2024 - Maj 2025



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Daljet e shtetasve

Në muajin Maj 2025, 710.048 shtetas shqiptarë numërohen të kenë dalë nga territori i Shqipërisë, duke shënuar rritje me 7,2 %, krahasuar me Maj 2024.

Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Maj 2025, janë 945.052. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ky tregues ka rënë me 0,9 % (tab.1).

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Maj 2024	Maj 2025	Ndryshimi vjetor %	Janar - Maj 2024	Janar - Maj 2025	Ndryshimi vjetor %
Hyrje Gjithsej	1.606.520	1.676.222	4,3	6.171.751	6.535.137	5,9
Shqiptarë	632.832	689.145	8,9	2.868.821	3.102.690	8,2
Të Huaj	973.688	987.077	1,4	3.302.930	3.432.447	3,9
Dalje Gjithsej	1.615.862	1.655.100	2,4	6.414.297	6.750.307	5,2
Shqiptarë	662.095	710.048	7,2	3.031.256	3.277.309	8,1
Të Huaj	953.767	945.052	-0,9	3.383.041	3.472.998	2,7

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Në Maj 2025, 95 % e hyrjeve të shtetasve të huaj në Shqipëri janë nga rajoni i Evropës.

Evropa Jugore zë 72 % të hyrjeve të shtetasve të huaj nga kontinenti Evropian, ndjekur nga Evropa Perëndimore me 14 % (tab.2).

Tab. 2 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas rajonit

Periudha	Maj 2024	Maj 2025	Janar -Maj 2024	Janar -Maj 2025
Gjithsej	973.688	987.077	3.302.930	3.432.447
I. Afrika	3.555	4.668	8.643	13.311
II. Amerika	24.191	28.496	72.171	81.542
III. Azia Lindore dhe Paqësori	8.219	10.397	23.910	29.570
IV.Lindja e Mesme	1.790	2.807	5.093	7.625
V. Azia e Jugut	3.252	4.822	9.552	16.912
VI. Evropa	927.906	934.532	3.156.825	3.279.208
- Evropa Qëndrore / Lindore	63.938	55.197	163.344	159.815
- Evropa Veriore	42.730	47.692	131.230	142.792
- Evropa Jugore	689.015	670.518	2.521.926	2.556.262
- Evropa Perëndimore	105.276	126.282	246.017	309.214
- Evropa Lindore / Mesdheut	26.947	34.843	94.308	111.125
VII. Rajone të paspecifikuara	4.775	1.355	26.736	4.279

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Qëllimi i hyrjes në territorin shqiptar i shtetasve të huaj, në 98 % të rasteve është për qëllime personale, ku dominojnë hyrjet për Pushime, vizitë tek të afërm, etj. Në Maj 2025, ky tregues ka shënuar një rritje me 0,9 %, krahasuar me Maj 2024. Hyrjet e shtetasve të huaj për qëllime Biznesi dhe profesionale janë rritur me 26,1 % (tab.3).

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Maj 2024	Maj 2025	Ndryshimi vjetor %	Janar - Maj 2024	Janar - Maj 2025	Ndryshimi në %
Hyrje shtetas të huaj	973.688	987.077	1,4	3.302.930	3.432.447	3,9
I. Personale	954.753	963.203	0,9	3.222.044	3.333.227	3,5
1. Pushime. vizitë tek të afërm. etj.	928.977	916.778	-1,3	3.100.435	3.183.636	2,7
2. Trajtime shëndetësore	67	49	-26,9	322	160	-50,3
3. Qëllime fetare	16	26	62,5	137	150	9,5
4. Udhëtarë transit	25.693	46.350	80,4	121.150	149.281	23,2
II. Biznes dhe profesionale	18.935	23.874	26,1	80.886	99.220	22,7

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.
2. Trajtime shëndetësore
3. Qëllime fetare
4. Udhëtarë tranzit

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë informacion referojuni:

https://www.instat.gov.al/media/2940/revision_policy_2016.pdf

Diferencat statistikore midis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuark në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje.
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje.
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.